

Institucionet e kujdesit në Kosovë: Kapacitetet dhe shpërndarja gjeografike në kontekstin e punësimit të grave



Institucionet e kujdesit në Kosovë:
Kapacitetet dhe shpërndarja gjeografike
në kontekstin e punësimit të grave

Shtator 2026

Deklaratë mohimi:

Ky raport i shkurtër është realizuar në kuadër të projektit "Më Shumë Zgjedhje: Politikat e Përgjegjshme Gjinore për Familjen për Sektorin Privat në Ballkanin Perëndimor – Faza 2", i zbatuar në Kosovë nga Instituti Riinvest – Forumi Ekonomik i Grave, i mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi (UNFPA) dhe i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), njësia operationale e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Ky raport është përgatitur nga Instituti GAP.

Verzioni origjinal i këtij raporti është shkruar në gjuhën angleze.

— Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje ekzekutive	5
1. Hyrje	6
2. Metodologjia	7
2.1. Kufizime	8
3. Shërbimet e kujdesit në Kosovë	8
3.1. Shërbimet e kujdesit për fëmijët e moshës 0–6 vjeç	9
3.2. Shërbimet e kujdesit për të moshuarit (65+)	13
3.3. Nevojat demografike në raport me infrastrukturën e institucioneve parashkollore për fëmijë	15
3.3.1 Numri i institucioneve parashkollore për 1,000 fëmijë sipas komunës	15
3.3.2 Disponueshmëria e institucioneve parashkollore sipas vendbanimeve	17
4. Ndikimi i institucioneve të kujdesit në përfshirjen e grave në tregun e punës	22
4.1. Pjesëmarrja e grave në tregun e punës në Kosovë	22
4.2. Ndërlidhja në mes të qasjes në institucione të kujdesit dhe punësimit të grave	23
4.2.1 Joaktiviteti dhe papunësia e grave në Kosovë sipas komunave dhe korrelacioni me disponueshmërinë e institucioneve parashkollore	25
5. Përfundime dhe rekomandime	28
Aneks	30

Lista e shkurtesave

AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB	Banka Botërore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IP	Institucione Parashkollore
KE	Komisioni European
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
OBEZh	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
UA	Udhëzim Administrativ

Përmbledhje ekzekutive

Pjesëmarrja në tregun e punës në Kosovë mbetet mjaft e ulët, veçanërisht tek gratë, me rreth 74% të grave në moshë pune që ishin ekonomikisht jo-aktive në vitin 2024. Pjesëmarrja e kufizuar e grave ndikohet nga disa faktorë të ndërlidhur, përfshirë normat shoqërore dhe tradicionale që u caktojnë atyre përgjegjësinë kryesore për kujdesin e fëmijëve dhe të moshuarve, si dhe qasjen e kufizuar në shërbime të përballueshme për këto kategori. Në këtë kontekst, disponueshmëria e shërbimeve të kujdesit është e rëndësishme jo vetëm për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të moshuarve, por edhe për reduktimin e përgjegjësisë të papaguara të kujdesit nga ana e grave dhe mundësimin e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës.

Ky raport vlerëson disponueshmërinë dhe shpërndarjen gjeografike të institucioneve parashkollore për fëmijët e moshës 0 deri në nën 6 vjeç dhe të qendrave të kujdesit për personat e moshës mbi 65 vjeç, si dhe shkallën e përputhjes së tyre me nevojat demografike. Gjithashtu, raporti vlerëson ndërlidhjen mes disponueshmërisë së institucioneve parashkollore dhe joaktivitetit e papunësisë së grave në nivel komunal. Gjetjet tregojnë pabarazi të ndjeshme në qasjen në edukim në fëmijërinë e hershme. Në Kosovë janë gjithsej 278 institucione parashkollore të regjistruara, mirëpo rreth 81% e tyre janë të përqendruara në zonat urbane, duke kufizuar qasjen për familjet në vendet rurale. Rreth 26% e fëmijëve të moshës 0 deri në 6 vjeç janë të regjistruar në arsimin parashkollor dhe parafillor, ndërsa regjistrimi i fëmijëve të moshës 0 deri në 4 vjeç është edhe më i ulët, në rreth 13%. Në nivel komunal, regjistrimi i përgjithshëm varion nga 41% në Prishtinë deri në 11% në Dragash dhe 15% në Obiliq. Pjesa më e madhe e komunave kanë më pak se dy institucione parashkollore për 1,000 fëmijë, ndërsa dhjetë komuna kanë vetëm një ose më pak. Shpërndarja gjeografike është gjithashtu e pabarabartë në nivel vendbanimi, ku shumë vendbanimeve rurale u mungojnë shërbimet parashkollore, pavarësisht se kanë një numër të konsiderueshëm fëmijësh. Këto mangësi, të kombinuara me transportin e kufizuar dhe të kushtueshëm në zonat rurale, rrisin vështirësitë me të cilat përballen gratë për të balancuar përgjegjësitë e kujdesit me punësimin e tyre.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë për një ndërlidhje në mes të disponueshmërisë së institucioneve parashkollore dhe shkallës së pjesëmarrjes dhe punësimit të grave në tregun e punës. Në 27 komunat e përfshira në këtë raport, ekziston një korrelacion negativ i moderuar mes disponueshmërisë së institucioneve parashkollore dhe joaktivitetit të grave në tregun e punës, gjë që tregon se komunat me më shumë institucione parashkollore në raport me numrin e fëmijëve, kanë normë më të ulët të joaktivitetit të grave. Ky korrelacion është edhe më i fortë sa i përket papunësisë së grave. Për shembull, Prishtina ka numrin më të lartë të institucioneve parashkollore, me 5.2 institucione për 1,000 fëmijë, si dhe normën më të ulët të joaktivitetit të grave, në 46.1%. Në anën tjetër, Dragashi ka vetëm 0.5 institucione për 1,000 fëmijë dhe një normë të joaktivitetit të grave prej 85.2%. Ndonëse prania e institucioneve parashkollore nuk është faktori i vetëm që ndikon në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe rezultatet nuk duhet të interpretohen si shkak-pasojë, ato ofrojnë dëshmi mbështetëse se disponueshmëria më e madhe e kujdesit ndaj fëmijëve ndërlidhet me rezultate më të favorshme për gratë në tregun e punës.

Pabarazitë shfaqen qartë edhe në shërbimet e kujdesit për të moshuarit. Kosova ka rreth 178,000 persona të moshës mbi 65 vjeç, ndërsa vetëm 15 institucione publike dhe me bazë në komunitet (rezidenciale dhe të kujdesit ditor) funksionojnë në komunat e përfshira në analizë. Disa komuna me popullsi të madhe të moshuar, përfshirë Pejën, Gjakovën, Mitrovicën e Jugut, Podujevën dhe Vushtrrinë, nuk kanë asnjë qendër publike të kujdesit për të moshuarit. Në mungesë të alternativave formale të kujdesit, kjo barrë bie kryesisht mbi familjet dhe në mënyrë të pabarabartë mbi gratë, duke kufizuar edhe më shumë mundësitë e tyre për t'u punësuar ose për të qëndruar në tregun e punës.

Bazuar në këto rezultate, të dhënat mbështesin nevojën për investime të targetuara për të zgjeruar qasjen në institucione parashkollore të përbalueshme në ato komuna dhe vendbanime ku ofrimi i tyre është i kufizuar, duke u bazuar në nevojat demografike dhe duke u shoqëruar me sigurimin e cilësisë. Komunitet gjithashtu duhet të zgjerojnë shërbimet e kujdesit për të moshuarit, veçanërisht duke hapur qendra të kujdesit ditor në zonat me numër më të madh të të moshuarve, ku shërbime të tilla aktualisht mungojnë. Kriteret e regjistrimit në institucionet publike parashkollore duhet të rishikohen për të siguruar që fëmijët, prindërit e të cilëve nuk janë aktualisht të punësuar, të mos penalizohen, pasi kjo nga ana tjetër mund të krijojë një pengesë për gratë që kërkojnë të futen në marrëdhënie pune. Këto masa duhet të plotësohen me politika familjare të përgjegjshme ndaj perspektivës gjinore, duke përfshirë kujdesin e subvencionuar ndaj fëmijëve për gratë që punësohen, si dhe transportin e përmirësuar dhe të subvencionuar në zonat rurale. Prandaj, zgjerimi dhe shpërndarja më e mirë e shërbimeve të kujdesit duhet të shihet jo vetëm si një masë e politikës sociale, por edhe si një investim për të ulur joaktivitetin e grave, rritur pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës dhe për të fuqizuar potencialin ekonomik të Kosovës.

1. Hyrje

Tregu i punës në Kosovë karakterizohet nga një nivel i ulët i aktivitetit ekonomik, me një shkallë të joaktivitetit prej 57% në vitin 2024, veçanërisht tek gratë, të cilat vazhdojnë të jenë më pak të angazhuara në krahasim me burrat, ku shkalla e joaktivitetit të tyre në tregun e punës është 74%.¹ Disa faktorë të ndërlidhur ndikojnë në pjesëmarrjen e ulët të grave në tregun e punës, përfshirë normat shoqërore dhe tradicionale që u ngarkojnë grave përgjegjësitë familjare për kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, mungesën e qasjes në shërbimet e kujdesit për fëmijët, qasjen e kufizuar ose koston e lartë të transportit, si dhe mungesën e politikave të punësimit të favorshme për familjen.² Si pasojë e këtyre faktorëve, gratë shpesh mbeten jashtë tregut të punës ose angazhohen në punë me orar të shkurtuar dhe joformale, duke kufizuar si potencialin e tyre ekonomik, ashtu edhe atë të ekonomisë në përgjithësi.

Një faktor që kufizon pjesëmarrjen e grave në tregun e punës është disponueshmëria dhe qasja e kufizuar në shërbime të kujdesit për fëmijët. Në Kosovë, pjesëmarrja në edukimin në fëmijërinë e hershme mbetet dukshëm nën mesataren rajonale dhe larg standardeve evropiane. Mungesa e institucioneve parashkollore (IP), kapacitetet e kufizuara të regjistrimit dhe shpërndarja e tyre e pabarabartë gjeografike krijojnë pengesa të mëdha për prindërit që kërkojnë të hynë ose të mbeten në marrëdhënie pune, ku gratë preken në mënyrë të pabarabartë nga këto kufizime. Si rrjedhojë, shërbimet parashkollore të besueshme dhe të qasshme nuk janë vetëm një investim në zhvillimin e fëmijëve, por edhe një komponentë thelbësore e infrastrukturës së tregut të punës. Përmes reduktimit të përgjegjësisë të papaguara të kujdesit, zgjerimi i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve mund t'u mundësojë grave të punësohen, të rrisin orët e tyre të punës, të ndjekin zhvillimin profesional dhe të mbeten ekonomikisht aktive. Në të kundërtën, ofrimi i pamjaftueshëm i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve mund t'i nxjerrë gratë jashtë marrëdhënies së punës ose të dekurajojë futjen e tyre në tregun e punës, gjë që sjell humbje të shkathtësive, të të ardhurave dhe të kapacitetit prodhues si për familjet, ashtu edhe për ekonominë në përgjithësi.

Ngjashëm, mungesa e shërbimeve të kujdesit ditor dhe qendrave për të moshuarit shpesh i detyron familjet që t'i marrin përsipër këto përgjegjësi përmes punës së papaguar, një barrë që rëndon në mënyrë joproporcionale mbi gratë. Për këtë arsye, fuqizimi i sistemeve të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit përbën një hap thelbësor për largimin e pengesave strukturore ndaj punësimit të grave dhe për aktivizimin e

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. [Treguesit Kryesorë të Tregut të Punës 2012–2024](#).

² Kosovo Women's Network. Who cares? Demand, Supply, and Options for Expanding Childcare Availability in Kosovo. 2016

një pjese më të madhe të fuqisë punëtore të grave në Kosovë. Zgjerimi i ekonomisë së kujdesit sjell një përfitim të dyfishtë: krijon vende të reja pune në këtë sektor dhe u mundëson grave të përfshihen plotësisht në tregun formal të punës.

Duke marrë parasysh këto çështje, ky raport shqyrton disponueshmërinë e institucioneve parashkollore për fëmijët e moshës 0 deri në nën 6 vjeç dhe të shërbimeve të kujdesit për personat e moshës mbi 65 vjeç, duke analizuar kërkesën dhe ofertën në nivel komunal dhe vendbanimi. Analiza ofron një pasqyrim gjithëpërfshirës të infrastrukturës së kujdesit në Kosovë, duke identifikuar boshllëqet gjeografike dhe demografike në ofrimin e shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, si dhe duke vlerësuar se si mungesa apo disponueshmëria e këtyre shërbimeve ndërlidhet me pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Në këtë mënyrë, raporti synon të shërbejë si bazë për politika dhe investime të targetuara që zgjerojnë shërbimet e kujdesit, duke larguar njëkohësisht barrierat strukturore ndaj punësimit të grave dhe duke fuqizuar pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës.

2. Metodologjia

Metodologjia e këtij raporti bazohet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave zyrtare për institucionet parashkollore dhe qendrat e kujdesit për të moshuarit sipas komunave dhe vendbanimeve, si dhe në të dhënat më të fundit të regjistrimit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) të vitit 2024 për fëmijët e moshës 0 deri në nën 6 vjeç (0-<6) dhe personat mbi moshën 65 vjeç. Të dhënat për institucionet parashkollore përfshijnë ato institucione që ofrojnë arsim parashkollor dhe parafillor, dhe janë mbledhur nga raportet zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), si dhe nga Drejtoritë e Arsimit të 27 komunave të përfshira në raport³, deri në fund të vitit 2025. Të dhënat lidhur me shtëpitë rezidenciale dhe qendrat e kujdesit ditor për të moshuarit janë mbledhur nga Drejtoritë për Mirëqenie Sociale të komunave përkatëse përmes kërkesave zyrtare për qasje në të dhëna, për të njëjtën periudhë, deri në fund të vitit 2025.

Për më tepër, për këtë raport janë llogaritur dy tregues të qasshmërisë dhe mbulimit, me qëllim që të vlerësohet niveli aktual i ofrimit të shërbimeve parashkollore dhe të identifikohen nevojat prioritare nëpër komuna. Treguesi i parë përfshin numrin e institucioneve parashkollore në çdo komunë për 1,000 fëmijë të moshës 0 deri në nën 6 vjeç.⁴ Kjo tregon shkallën në të cilën çdo komunë është e mbuluar me institucione parashkollore në raport me numrin e fëmijëve që jetojnë atje. Treguesi tjetër analizon situatën në nivel vendbanimi. Më konkretisht, ky tregues llogarit përqindjen e vendbanimeve që kanë institucione parashkollore në çdo komunë. Në këtë mënyrë, pasqyrohet mbulimi gjeografik i shërbimeve parashkollore brenda secilës komunë dhe shkalla në të cilën institucionet parashkollore janë të shpërndara nëpër vendbanimet e saj, duke nxjerrë në pah dallimet në mundësitë e shfrytëzimit dhe mangësitë e mundshme gjeografike në ofrimin e kujdesit ndaj fëmijëve.

Për analizë të mëtejshme, raporti llogarit gjithashtu shkallën e joaktivitetit dhe të papunësisë së grave për secilën komunë. Kjo mundëson një vlerësim nëse komunat me mbulim më të madh të shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve priren të kenë shkallë më të ulët të joaktivitetit dhe papunësisë së grave, duke bërë ndërlidhjen në mes të pranisë së infrastrukturës së kujdesit dhe pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Të dhënat në nivel komunal për punësimin e grave dhe statusin e tyre në tregun e punës në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³ Në këtë analizë janë përfshirë vetëm komunat që janë përgjigjur në kërkesat për të dhëna. Si rrjedhojë, 11 komuna nga gjithsej 38 nuk janë përfshirë.

⁴ Për llogaritjen e këtij treguesi, për konsistencë metodologjike, janë përfshirë vetëm fëmijët e moshës 0-<6 vjeç.

2.1. Kufizime

Janë disa kufizime që duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të gjetjeve të këtij raporti. Fillimisht, raporti fokusohet në shërbimet e kujdesit për fëmijë të moshës 0–<6 vjeç dhe shërbimet e kujdesit për personat mbi 65 vjeç dhe nuk përfshin shërbime të kujdesit për personat me aftësi të kufizuara. Për më tepër, analiza e kujdesit për fëmijë mat numrin dhe praninë gjeografike të institucioneve parashkollore (IP), por nuk vlerëson kapacitetin e tyre në aspektin e numrit të vendeve të disponueshme për fëmijë. Rrjedhimisht, prania e një IP-je nuk do të thotë domosdoshmërisht që ka vende të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën lokale. Në nivel vendbanimi, treguesi që mat përqindjen e vendbanimeve me IP i trajton të gjitha vendbanimet në mënyrë të barabartë, pavarësisht madhësisë ose popullsisë së tyre. Kështu, ai reflekton më shumë shpërndarjen gjeografike të shërbimeve sesa përqindjen e popullsisë me qasje në shërbimet e kujdesit për fëmijë.

Në nivel vendbanimi, analiza përfshin vetëm fëmijët në grupmoshën 0–4 vjeç, për shkak të ndarjes së grupmoshave në të dhënat e paraqitura nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), të cilat janë të ndara në 0–4 dhe 5–9 vjeç. Si pasojë, për të siguruar saktësi më të madhe, është përfshirë vetëm grupmosha 0–4 vjeç. Për më shumë, kjo analizë nuk llogarit ndonjë tregues që analizon ndërlidhjen e shërbimeve të kujdesit për të moshuarit dhe pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, për shkak të kufizimeve me të dhëna. Vlerësimet në këtë raport bazohen në të dhënat e popullsisë së vitit 2024, dhe nuk përfshijnë projeksione demografike. Rrjedhimisht, raporti reflekton situatën në një moment të caktuar në kohë dhe nuk përllogarit ndryshimet e mundshme në të ardhmen si rezultat i zhvendosjeve demografike, migrimit, apo ndryshimeve në strukturën e moshës. Përveç kësaj, komunat me shumicë joshqiptare nuk janë përfshirë në analizë për shkak të mungesës së të dhënave dhe mos-përgjigjes ndaj kërkesave zyrtare.

Së fundi, shkalla e joaktivitetit dhe papunësisë së grave në nivel lokal është llogaritur duke përdorur të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe jo nga Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP), e cila është burimi standard për treguesit e tregut të punës. Megjithatë të dhënat e regjistrimit mundësojnë ndarjen e nevojshme në nivel komunal, dallimet në metodologji nënkuptojnë që këto shifra duhet të interpretohen me kujdes dhe nuk duhet të trajtohen si drejtpërdrejtë të krahasueshme me vlerësimet e bazuara në AFP.

3. Shërbimet e kujdesit në Kosovë

Në Kosovë, shërbimet e kujdesit përfshijnë një numër të shërbimeve dhe institucioneve që ofrojnë mbështetje për fëmijët, të moshuarit dhe grupet e tjera të cënueshme që kanë nevojë për ndihmë për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre. Këto shërbime ofrohen nga institucione të ndryshme publike, ofrues privatë ose organizata joqeveritare, dhe rregullohen përmes legjisllacionit përkatës.⁵ Shërbimet e kujdesit ndahen në tri kategori: shërbimet e kujdesit për fëmijët, shërbimet e kujdesit për të moshuarit dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara. Shërbimet e kujdesit për fëmijët i referohen mbikëqyrjes, kujdesit dhe edukimit të hershëm të fëmijëve. Shërbimet e kujdesit për të moshuarit përfshijnë shtëpitë rezidenciale për të moshuarit, qendrat e kujdesit ditë dhe shërbimet e kujdesit në shtëpi. Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara përfshijnë qendrat e kujdesit ditë që ofrojnë shërbime ndihmëse, mbështetje të specializuar dhe shërbime rehabilituese/terapeutike.⁶

Në Kosovë janë gjithsej 131,255 fëmijë nën moshën gjashtë vjeç, që përbëjnë rreth 10% të popullsisë, ndërsa janë 177,915 individë të moshës mbi 65 vjeç, që përbëjnë

⁵ Gazeta Zyrtare. [Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Udhëzim Administrativ \(MESTI\) Nr.03/2022 mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë.](#)

⁶ Po aty

rreth 11% të popullsisë. Për qëllimet e këtij studimi, shërbimet e kujdesit për fëmijët përfshijnë vetëm shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme për fëmijët nga lindja deri në moshën gjashtë vjeç, ku përfshihen institucionet parashkollore dhe parafillore. Shërbimet e kujdesit për të moshuarit (moshave 65+) në këtë raport i referohen shtëpive rezidenciale të kujdesit për të moshuarit dhe qendrave të kujdesit ditor.

3.1. Shërbimet e kujdesit për fëmijët e moshës 0–6 vjeç

Shërbimet e kujdesit për fëmijët e moshës 0–6 vjeç ofrohen përmes institucioneve parashkollore dhe parafillore, si çerdhet, kopshtet dhe shkollat fillore.⁷ Edukimi në fëmijërinë e hershme në Kosovë rregullohet përmes Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme⁸, i cili synon të përcaktojë normat e organizimit për kujdesin ndaj fëmijëve nga lindja deri në moshën gjashtë vjeç, si dhe standardet për funksionimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Që nga viti 2023, regjistrimi i fëmijëve në edukimin parafillor nga mosha pesëvjeçare deri në fillimin e arsimit fillor është bërë i detyrueshëm sipas këtij ligji.

Ligji përcakton disa lloje të institucioneve parashkollore: publike, private, publiko-private, të bazuara në komunitet, dhe shkolla fillore (të cilat në disa raste ofrojnë edukim në fëmijërinë e hershme duke filluar nga mosha trivjeçare). Përveç kësaj, Udhëzimi Administrativ (UA) për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë⁹ përcakton dy ndarje të grupmoshave brenda institucioneve parashkollore: nga 9 muaj deri në 3 vjeç (çerdhet) dhe nga 3 deri në 6 vjeç (kopshtet). Sipas këtij Udhëzimi Administrativ, në institucione publike, fëmijët mund të përfshihen nga mosha 9 muajshe, ndërsa në institucione private regjistrimi mund të fillojë në moshën 6 muajshe. Përveç kësaj, ky udhëzim përcakton kriteret për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore publike dhe u autorizon asambleve komunale të përcaktojnë tarifën bazuar në të ardhurat e familjes, si dhe përjashtimet për grupe të caktuara.¹⁰ Përcaktimi i kriterëve të përfshirjes në institucione publike parashkollore bëhet nga komuna përkatëse, e cila i liston ato në thirrjen publike për vende të lira. Për shembull, në thirrjen publike të nxjerrë nga Komuna e Prishtinës, prioritetet për pranim u ishte dhënë fëmijëve bonjakë, fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijëve të invalidëve të luftës dhe veteranëve, fëmijëve të prindërve të ndarë, dhe fëmijëve të familjeve ku të dy prindërit punojnë por kanë të ardhura më të ulëta.¹¹

Në Kosovë janë gjithsej 278 institucione parashkollore të regjistruara.¹² Prej tyre, 99 janë institucione publike parashkollore, 166 janë private dhe 13 janë publiko-private ose me bazë në komunitet. Në aspektin gjeografik, këto institucione parashkollore janë të përqendruara kryesisht në zonat urbane, ku ndodhen rreth 81% e tyre, ndërsa afërsisht 19% gjenden në zonat rurale.¹³ Në nivel lokal, të gjitha 27 komunat e përfshira në këtë raport kanë institucione parashkollore funksionale për fëmijët. Komuna me numrin më të madh të institucioneve parashkollore është Prishtina, me gjithsej 101 të tilla. Komunat e tjera me një numër relativisht të lartë të institucioneve parashkollore përfshijnë Fushë Kosovën, Gjakovën, Pejën dhe Gjiçanin, me përkatësisht 22, 15 dhe 14 institucione. Ndërkaq, komunat me numrin më të ulët të institucioneve parashkollore janë Dragashi, Hani i Elezit, Kaçaniku, Kamenica, Klinë dhe Juniku, secila me vetëm nga një institucion parashkollor.

7 Gazeta Zyrtare. [Ligji mbi Edukimin e Fëmijërisë së hershme](#). Qasur më 3 dhjetor, 2025.

8 Po aty

9 Gazeta Zyrtare. [Udhëzim Administrativ \(MESTI\) Nr.03/2022 mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë](#). Qasur më 3 dhjetor, 2025


10 Po aty

11 Komuna e Prishtinës. Drejtoria e Arsimit. [Konkursi për Regjistrimin dhe Çregjistrimin e Fëmijëve në Institucione Parashkollore të Komunës së Prishtinës për Vitin Akademik 2019–2020](#).

12 Disa institucione parashkollore të regjistruara ofrojnë gjithashtu arsimin parafillor për fëmijë të moshës 5–6 vjet.

13 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit.


Figura 1. Numri i institucioneve parashkollore (IP) në Kosovë sipas llojit dhe shpërndarjes gjeografike (%) sipas zonës



Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit

Duke analizuar numrin e institucioneve parashkollore në raport me numrin e fëmijëve të moshës 0–<6 vjeç (Figura 2), në shumicën e komunave mund të vërehet një korrelacion: sa më shumë fëmijë të ketë në këtë grupmoshë, aq më i lartë është numri i institucioneve parashkollore. Megjithatë, kjo nuk vlen për të gjitha komunat. Prizreni dhe Ferizaj, të cilat kanë numrin më të madh të fëmijëve pas Prishtinës, renditen shumë më poshtë sa i përket numrit të institucioneve parashkollore (në vendin e tetë dhe të gjashtë, përkatësisht). Në anën tjetër, Suhareka, me gjithë faktin se ka ndjeshëm më pak fëmijë në krahasim me disa komuna më të mëdha, renditet e shtata për nga numri i institucioneve parashkollore.

Figura 2. Numri i institucioneve parashkollore sipas llojit, komunës, dhe numrit të fëmijëve (mosha 0–<6)




Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Drejtoritë e Arsimit të Komunave; dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës

Një tregues i rëndësishëm që pasqyron situatën aktuale të edukimit në fëmijërinë e hershme, përtej disponueshmërisë së institucioneve parashkollore, është shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve të grupmoshës përkatëse (0–<6 vjeç) në arsimin parashkollor dhe parafillor. Sipas të dhënave për vitin shkollor 2024/2025, gjithsej 33,887 fëmijë ishin të regjistruar në institucionet parashkollore dhe parafillore në Kosovë. Prej tyre, rreth 70% ishin të regjistruar në institucione publike dhe 30% në institucione private. Përveç kësaj, është e rëndësishme të theksohet se më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të fëmijëve të regjistruar në edukimin parashkollor (59%) i përkasin grupmoshës parafillore (5–<6 vjeç). Ndërkaq, rreth 41% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve të regjistruar ishin të grupmoshës parashkollore (0–5 vjeç).¹⁴ Kur analizohet si përqindje e numrit të përgjithshëm të fëmijëve në këtë grupmoshë, rezulton se rreth 26% e fëmijëve të moshës 0–<6 vjeç në Kosovë janë të regjistruar në arsimin parashkollor dhe parafillor.

¹⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës. [Statistikat e Arsimit në Kosovë 2024–2025](#). Qasur më 3 dhjetor, 2025


Figura 3. Regjistrimi i fëmijëve të moshës 0-<6 vjeç në arsimin parashkollor dhe parafillor sipas komunave për vitin shkollor 2024/2025



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në nivel komunal, shkalla më e lartë e pjesëmarrjes është në Komunën e Prishtinës me 41%, e përcjellur nga Komuna e Gjilanit dhe Pejës me 31%, dhe Gjakovës me 29%. Ndërkaq, komunat me shkallët më të ulëta të regjistrimit, duke përjashtuar ato me popullsi me shumicë serbe, janë Dragashi dhe Obiliq, me përkatësisht vetëm 11% dhe 15% të fëmijëve të regjistruar në institucionet parashkollore. Kur zbërthehen në dy grupmosha, fëmijët në institucionet parashkollore (0-4 vjeç) dhe ato parafillor (5-<6 vjeç), shkallët e regjistrimit shfaqin dallime të konsiderueshme. Të dhënat tregojnë se shkalla mesatare e regjistrimit në edukimin parashkollor për fëmijët e moshës 0-4 vjeç në Kosovë është 13%. Komunat me shkallën më të lartë të regjistrimit në këtë grupmoshë janë: Prishtina (31.4%), Gjakova (18.4%), Peja (17.5%) dhe Fushë Kosova (16.8%). Në anën tjetër, komunat me shkallën më të ulët të regjistrimit në këtë grupmoshë janë: Dragashi (0%), Skenderaj (2.9%), Obiliq (2.9%) dhe Deçani (4.2%).

Figura 4. Regjistrimi i fëmijëve të moshës 0-4 vjeç në arsimin parashkollor sipas komunave për vitin shkollor 2024/2025




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Sa i përket arsimit parafillor, të dhënat tregojnë se shkalla mesatare e regjistrimit për fëmijët e moshës 5-<6 vjeç¹⁵ në Kosovë është 77%, që është ndjeshëm më e lartë se ajo e grupmoshës parashkollore. Kur analizohet sipas komunave, shkalla më e lartë e regjistrimit është në Gjilan me 98%, në Lipjan dhe Viti me 89%, si dhe në Pejë me 88%. Shkalla më e ulët e regjistrimit për këtë grupmoshë është në komunat: Fushë Kosovë (52%), Obiliq (55%) dhe Dragash (62%).

¹⁵ Shkalla e regjistrimit në arsimin parafillor llogaritet duke pjesëtuar numrin e fëmijëve të regjistruar në institucionet parafillor publike dhe private me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të moshës 5-vjeçare në ato komuna (duke përfshirë edhe një numër të vogël fëmijësh të moshës 6-8 vjeç që janë të regjistruar në arsimin parafillor sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë).


Figura 5. Regjistrimi i fëmijëve të moshës 5-<6 vjeç në arsimin parafillor sipas komunave për vitin shkollor 2024/2025



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

*Numri i përgjithshëm i fëmijëve të moshës 5-vjeçarë përfshin gjithashtu edhe një numër të vogël fëmijësh të moshës 6-8 vjeç që janë të regjistruar në arsimin parafillor sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë

Figura 6. Përqindja e fëmijëve të regjistruar të moshës 0-6 vjeç në arsimin parashkollor




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në krahasim me mesataren e Bashkimit Evropian dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova renditet e treta nga fundi sa i përket pjesëmarrjes së fëmijëve mbi 3 vjeç në edukimin e fëmijërisë së hershme. Përqindja e pjesëmarrjes së fëmijëve mbi 3 vjeç në edukimin e fëmijërisë së hershme në Kosovë në vitin 2021 ishte 37.8%. Në anën tjetër, në mesin e vendeve të rajonit, Shqipëria qëndron më së miri me një shkallë pjesëmarrjeje prej 82.9%, e pasuar nga Serbia dhe Mali i Zi me përkatësisht 65.5% dhe 57.2%. Përqindjen më të ulët në rajon e ka Bosnja dhe Hercegovina me një pjesëmarrje prej 28.5%, e pasuar nga Maqedonia e

Veriut me 33.8%. Nga ana tjetër, mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian është shumë më e lartë, duke qendruar në 91.8% në vitin 2022.¹⁶

Figura 7. Përqindja e pjesëmarrjes së fëmijëve mbi 3 vjeç në arsimin parashkollor në vendet e rajonit dhe në BE (2021)



Burimi: Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), 2024

Komisioni Evropian (KE) ka vendosur disa objektiva për përqindjen e fëmijëve të regjistruar në edukimin e fëmijërisë së hershme që nga viti 2022 për vitin 2030. Sipas rekomandimeve të KE, të paktën 45% e fëmijëve nën 3 vjeç duhet të jenë të regjistruar në arsimin parashkollor, ndërsa për fëmijë të moshës 3–6 vjeç kjo përqindje duhet të jetë 96%. Për më tepër, këto rekomandime propozojnë që vendet anëtare të marrin masat e nevojshme për të ofruar shërbime të kujdesit më të qasshme, përballueshme dhe të cilësisë më të mirë në periudhë më afatgjatë. Një nga këto masa është mbyllja e hendekut gjeografik përmes masave më të targetuara, veçanërisht në zona rurale dhe në zona më pak të populluara, me qëllim që të mundësohet qasje edhe në këto zona.¹⁷ Ndër të tjera, Strategjia Evropiane e Kujdesit rekomandon të merret parasysh numri i orëve që fëmijët kalojnë në institucione parashkollore ('intensiteti i kohës') me qëllim të sigurimit të kohës së mjaftueshme për prindërit për punë.¹⁸

3.2. Shërbimet e kujdesit për të moshuarit (65+)

Shërbimet e kujdesit për të moshuarit janë shumë të rëndësishme, pasi kjo kategori shpesh ka nevojë për mbështetje dhe asistencë. Ofrimi i këtyre shërbimeve u mundëson të moshuarve të kenë një mirëqenie dhe jetë më të mirë. Në Kosovë, sipas të dhënave të vitit 2024, janë gjithsej 177,915 persona mbi moshën 65-vjeçare, duke përbërë rreth 11% të popullsisë. Sa u përket komunave, komuna me numrin më të madh të të moshuarve është Prishtina me gjithsej 23,866 persona, e pasuar nga Prizreni me rreth 16,345 persona, si dhe Peja, Ferizaj dhe Gjakova me rreth 10,000 persona secila.¹⁹

Të moshuarit, si kategori në nevojë, mund të kenë nevoja të ndryshme për shërbimet e kujdesit siç janë shërbimet shëndetësore, kujdesin për aktivitetet e përditshme, kujdes rezidencial për ata që jetojnë vetëm ose nuk kanë anëtarë të tjerë familje, ose shërbime të tjera sociale. Shërbimet sociale për të moshuarit rregullohen sipas dy ligjeve kryesore në Kosovë: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare²⁰ dhe Ligji i Familjes.²¹ Këto ligje, dhe legjislacioni shoqërues, përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike që hartojnë politika sociale dhe familjare dhe

¹⁶ Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). [Competitiveness and Private Sector Development. Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Regional Profile](#). Qasur më 3 dhjetor, 2025.

¹⁷ Këshilli i Evropës. Konferencë për media. [EU ministers adopt recommendations on early childhood and long term care](#). Qasur më 23 nëntor, 2025.

¹⁸ Komisioni Evropian. [A European Care Strategy for caregivers and care receivers](#). Qasur më 23 nëntor, 2025.

¹⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). [Regjistrimi i Popullsisë: Numri i popullsisë sipas moshës së vetme, gjinisë dhe komunës, 2011 dhe 2024](#). Qasur më 10 nëntor, 2025.

²⁰ Gazeta Zyrtare. [Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbimet Sociale dhe Familjare](#). Qasur më 10 nëntor, 2025


²¹ Gazeta Zyrtare. [Ligji për Familjen](#). Qasur më 18 nëntor, 2025

ofrojnë shërbime të tilla, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Disa nga këto institucione veprojnë në nivel qendror dhe monitorohen nga Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare brenda Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, dhe disa të tjera në nivel lokal dhe monitorohen nga Drejtoritë për Mirëqenie Sociale brenda komunave.

Në Kosovë, janë dy lloje të institucioneve të kujdesit për të moshuarit: institucione rezidenciale për të moshuarit (shtëpi për të moshuarit) dhe qendra të kujdesit ditor të bazuara në komunitet. Institucionet e kujdesit rezidencial trajtojnë personat e moshuar pa kujdes familjar, ndërsa qendrat e kujdesit ditor janë të hapura për të gjithë personat e moshuar për aktivitete të ndryshme sociale.²² Numri i institucioneve publike dhe qendrave të bazuara në komunitet për të moshuarit në Kosovë për 27 komunat e përfshira në këtë analizë është 15.²³ Prej tyre, tetë janë institucione rezidenciale për të moshuarit pa kujdes familjar dhe shtatë janë qendra që ofrojnë kujdes ditor për të moshuarit.²⁴

Figura 8. Numri i shtëpive dhe qendrave për të moshuarit në Kosovë

■ Institucionet rezidenciale për të moshuarit
■ Qendrat e qëndrimit ditor për të moshuarit




Burimi: Drejtoria e Mirëqenies Sociale për komuna

Në aspektin gjeografik, gjithsej 9 komuna kanë shtëpi rezidenciale ose qendra të kujdesit ditor për të moshuarit, nga të cilat Prishtina ka numrin më të madh (5), Suhareka (3), ndërsa komunat e tjera kanë nga një qendër secila. Shtëpitë e të moshuarve janë të shpërndara në Prishtinë, Suharekë, Prizren, Gjilan, Skenderaj, Istog dhe Kamenicë. Ndërkaq, qendrat ditore për të moshuarit ndodhen në Prishtinë (4), Ferizaj, Suharekë dhe Obiliq. Shtëpia e të moshuarve në Gjilan shërben gjithashtu edhe për qëndrim ditor.

Figura 9. Numri i shtëpive dhe qendrave për të moshuarit sipas komunave

■ Shtëpitë për të moshuarit ■ Qendrat ditore për të moshuarit



Burimi: Drejtoritë e Mirëqenies Sociale në komuna


²² Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MPFT). [Mirëqenia Sociale 2021](#). Qasur më 18 nëntor, 2025

²³ Institucionet private nuk janë përfshirë për shkak të mungesës së të dhënave.

²⁴ Për konsistencë metodologjike me seksionin për shërbimeve të kujdesit për fëmijë, komunat me pakicë nuk janë përfshirë (p.sh. Novobërda në këtë rast)

Kur analizohet numri i shtëpive dhe i qendrave për të moshuarit bazuar në numrin e personave të moshës 65+ vjeç, vërehet një korrelacion pozitiv mes numrit të të moshuarve dhe qendrave për të moshuarit në disa komuna të mëdha si Prishtina, Prizreni, Ferizaj dhe Gjiłani. Megjithatë, ka komuna me numër më të madh të të moshuarve që nuk kanë asnjë qendër publike, si: Peja, Gjakova, Mitrovica e Jugut, Podujeva dhe Vushtrria. Në anën tjetër, komunat me numër më të vogël të të moshuarve, si Obiliqi dhe Kamenica, kanë nga një qendër secila. Sa i përket vendndodhjes gjeografike nëpër vendbanime, shumica e qendrave ndodhen në vendbanimet kryesore të këtyre komunave (në qendra). Për këtë arsye, si dhe për shkak të numrit të vogël të qendrave, shpërndarja e tyre sipas vendbanimeve dhe popullsisë nuk është analizuar.

Figura 10. Numri i shtëpive rezidenciale dhe qendrave për të moshuarit sipas komunave dhe numri i personave mbi 65 vjeç



Burimi: Drejtoritë e Mirëqenies Sociale në komuna dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës

3.3. Nevojat demografike në raport me infrastrukturën e institucioneve parashkollore për fëmijë

Për të vlerësuar se sa të qasshme janë institucionet parashkollore dhe sa korrespondojnë ato me nevojat demografike, në këtë raport janë llogaritur dy indikatorë të bazuar në numrin aktual të institucioneve parashkollore dhe numrin e fëmijëve në komunat përkatëse. Indikatori i parë llogarit se sa institucione parashkollore ka secila komunë për çdo 1,000 fëmijë të moshës 0-6. Kjo tregon se në çfarë mase secila komunë mbulohet nga institucione parashkollore në raport me numrin e fëmijëve që jetojnë atje. Indikatori tjetër analizon situatën në nivel vendbanimi. Më konkretisht, ai llogarit numrin e vendbanimeve me institucione parashkollore si përqindje e të gjithë vendbanimeve brenda një komune. Kjo ndihmon për të kuptuar më qartë shpërndarjen e shërbimeve parashkollore brenda komunave dhe sa afër fëmijëve janë ato. Përveç kësaj, ai paraqet gjithashtu numrin e institucioneve parashkollore bazuar në vendbanime dhe numrin e fëmijëve të moshës 0-4 vjet.

3.3.1 Numri i institucioneve parashkollore për 1,000 fëmijë sipas komunës

Sipas rezultateve në Tabelën 1, në përgjithësi, mbulueshmëria me institucione parashkollore nëpër komuna është e ulët. Komuna e Prishtinës ka raportin më të lartë të institucioneve parashkollore të disponueshme për 1,000 fëmijë, me një raport të llogaritur prej 5.2. Komuna e Junikut gjithashtu ka një raport të lartë të disponueshmërisë (4.7); megjithatë, duhet pasur parasysh se është një komunë e vogël me vetëm një IP të hapur rishtazi. Komunat e tjera që kanë një raport

mesatar prej 2–3 institucionesh parashkollore për 1,000 fëmijë janë Gjakova, Suhareka, Fushë Kosova, Peja dhe Shtimja. Ndërkaq, komunat që pozicionohen nën mesataren, me 1–2 institucione parashkollore për 1,000 fëmijë, janë: Gjilani, Istogu, Lipjani, Vushtrria, Obiliqi, Drenasi, Hani i Elezit, Ferizaj, Rahoveci dhe Mitrovica e Jugut. Komunat me raportin më të ulët të institucioneve parashkollore, ku raporti për 1,000 fëmijë është nën 1, janë: Vitia, Podujeva, Prizreni, Deçani, Kamenica, Skenderaj, Dragashi, Malisheva, Kaçaniku dhe Klina.


Tabela 1. Institucionet aktuale parashkollore sipas komunave dhe numri i fëmijëve të moshës 0–<6 vjeç

Komuna	Gjithsej institucione parashkollore	Numri i fëmijëve (0–<6 vjeç)	Institucione parashkollore/1,000 fëmijë
Prishtinë	101	19268	5.2
Junik	1	213	4.7
Gjakovë	22	5870	3.7
Suharekë	12	3465	3.5
Fushë Kosovë	22	6926	3.2
Pejë	15	6021	2.5
Shtime	5	2154	2.3
Istog	14	2296	2.2
Gjilan	5	6431	2.2
Lipjan	10	4957	2.0
Vushtrri	8	5205	1.5
Obiliq	3	2048	1.5
Drenas	6	4332	1.4
Hani i Elezit	1	789	1.3
Ferizaj	12	9801	1.2
Mitrovicë e Jugut	4	5147	1.2
Rahovec	6	3442	1.2
Viti	3	2933	1.0
Prizren	12	11859	1.0
Podujevë	6	5941	1.0
Deçan	2	2026	1.0
Kamenicë	1	1389	0.7
Skenderaj	2	3209	0.6
Dragash	1	1953	0.5
Malishevë	2	4314	0.5
Kaçanik	1	2365	0.4
Klinë	1	2370	0.4

Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Drejtoritë e Arsimit të Komunave, dhe llogaritje të GAP

Këto rezultate tregojnë se ka dallime gjeografike në mes komunave, të cilat bazohen në ndryshimet e kapaciteteve nga njëra komunë në tjetrën.

Figura 11. Numri i institucioneve parashkollore për 1,000 fëmijë të moshës 0–<6 vjeç, sipas komunave



Në disa komuna të mëdha, si Prizreni dhe Ferizaj, përkundër numrit të madh të fëmijëve, raporti ndaj numrit të institucioneve parashkollore është mjaft i ulët. Për më tepër, vërehet një nevojë e theksuar për infrastrukturë, pasi shumica e komunave kanë më pak se dy institucione parashkollore për 1,000 fëmijë, çka dëshmon për kapacitete të pamjaftueshme. Megjithatë, edhe për komunat që kanë një raport më të lartë të institucioneve parashkollore për 1,000 fëmijë (për shembull Prishtina), mbi 200 fëmijë për institucion parashkollor mbetet ende një numër i konsiderueshëm dhe kërkon kapacitete të caktuara, të cilat shumë institucione të vogla private parashkollore mund të mos i kenë.


Sipas llogaritjeve²⁵ të bazuara në numrin e fëmijëve të regjistruar në institucionet parashkollore publike dhe private në Kosovë, mesatarja e ponderuar e fëmijëve për institucion parashkollor është 124. Në institucionet parashkollore publike, mesatarja e fëmijëve të regjistruar është 235, ndërsa në ato private është 63. Prandaj, bazuar në këto të dhëna dhe në raportin për 1,000 fëmijë, mund të evidentohet se ekziston një mungesë e institucioneve parashkollore.

3.3.2 Disponueshmëria e institucioneve parashkollore sipas vendbanimeve

Për të ekzaminuar më nga afër disponueshmërinë e institucioneve parashkollore nëpër komuna bazuar në numrin e fëmijëve, ky raport gjithashtu analizon të dhënat në nivel vendbanimi brenda secilës komunë. Në këtë mënyrë, komunat u vlerësuan bazuar në numrin e vendbanimeve që ato përmbajnë dhe sa nga këto kanë institucione parashkollore. Sipas këtyre të dhënave, komuna e Gjakovës dhe Suharekës kanë numrin më të lartë të institucioneve parashkollore nëpër vendbanime, me tetë secila.

²⁵ Llogaritjet u kryen bazuar në të dhënat aktuale mbi numrin e fëmijëve të regjistruar në institucionet publike dhe private parashkollore, si dhe mbi numrin e këtyre institucioneve. Për institucionet publike, numri total i fëmijëve të regjistruar u pjesëtua me numrin e institucioneve, ndërsa për institucionet private u llogarit një mesatare e thjeshtë nga lista e institucioneve private parashkollore të regjistruara. Mesatarja e ponderuar për institucionet private dhe publike u llogarit bazuar në ponderimin përkatës të numrit të institucioneve parashkollore.

Figura 12. Shpërndarja e institucioneve parashkollore sipas vendbanimeve në komuna: numri i vendbanimeve me institucione parashkollore



Source: Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Drejtoritë e Arsimit të komunave; dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës

Për të analizuar shpërndarjen gjeografike të institucioneve parashkollore brenda komunave, u llogarit një tregues që analizon numrin e vendbanimeve me institucione parashkollore si përqindje e të gjithë vendbanimeve brenda një komune. Rezultatet tregojnë se Suhareka ka shpërndarjen më të mirë gjeografike (20%), e ndjekur nga Fushë Kosova (19%), Obiliqi (17%), Prishtina dhe Shtimja (14%), dhe Rahoveci (11%). Juniku gjithashtu ka shpërndarje të mirë gjeografike – pavarësisht se është komunë e vogël me vetëm dy vendbanime, dhe 50% e tyre janë të mbuluar nga institucione parashkollore (1 nga gjithsej 2 vendbanime).

Hartëzimi i institucioneve parashkollore sipas vendbanimeve dhe numrit të fëmijëve (0–4 vjeç)²⁶ tregon pabarazi të ndjeshme në mes zonave urbane dhe rurale. Në shumë komuna, shpërndarja e IP nuk përputhet me kërkesën ose në numrin real të fëmijëve. Një komunë ku kjo është e evidente është Gjakova, e cila ka shtatë IP të shpërndara në vendbanime më të vogla se qendra, por gjashtë nga ato janë në vendbanime me mesatare prej 20 fëmijësh të moshës 0–4 vjeç. Nga ana tjetër, vendbanime të mëdha siç janë Damjani dhe Brekoci nuk kanë asnjë IP.

Tabela 2. Institucionet aktuale parashkollore sipas vendbanimeve dhe numri i fëmijëve të moshës 0–4 vjeç

Komuna	Vendbanimi	Fëmijë të moshës 0–4 vjeç	Numri i institucioneve parashkollore
Gjakovë		4849	22
	Gjakovë	2491	15
	Rogovë	242	1
	Shishman	24	1
	Devë	19	1
	Novosellë e Ulët	19	1
	Korenicë	18	1
	Bishtazhin	14	1
	Rrezinë	2	1
Gjilan		5319	14

²⁶ Në nivel vendbanimi, të dhënat e ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës e ndajnë numrin e fëmijëve sipas grupmoshave specifike, si: 0–4 dhe 5–9 vjeç. Si rrjedhojë, për analizën në nivel vendbanimi, fëmijët e moshës 5–<6 vjeç nuk janë përfshirë.

Komuna	Vendbanimi	Fëmijë të moshës 0-4 vjeç	Numri i institucioneve parashkollore
	Gjilan	3525	10
	Livoç i Ulët	202	1
	Livoç i Epërm	201	1
	Zhegër	166	1
	Dobërçan	100	1
Deçan		1664	2
	Deçan	164	2
Dragash		1621	1
	Dragash	89	1
Ferizaj		8175	12
	Ferizaj	3692	11
	Greme	272	1
Fushë Kosovë		5741	22
	Bresje	803	1
	Fushë Kosovë	3951	20
	Miradi e Poshtme	114	1
Drenas		3580	6
	Drenas	519	3
	Komoran	234	1
	Çikatovë e Re	137	2
Hani i Elezit		638	1
	Hani i Elezit	181	1
Istog		1914	5
	Istog	352	1
	Vrellë	128	1
	Gjurakoc	93	1
	Banjë	67	1
	Rakosh	30	1
Junik		178	1
	Junik	177	1
Kaçanik		1937	1
	Kaçanik	526	1
Kamenicë		1143	1
	Kamenicë	243	1
Klinë		1960	1
	Klinë	337	1
Lipjan		4099	10
	Lipjan	1021	4
	Gadime e Ulët	237	1
	Sllovi	191	1
	Shalë	138	1

Komuna	Vendbanimi	Fëmijë të moshës 0-4 vjeç	Numri i institucioneve parashkollore
	Konjuh	38	2
	Rufc i Ri	21	1
Malishevë		3516	2
	Kijevë	81	1
	Malishevë	314	1
Mitrovicë e Jugut		4236	6
	Mitrovicë e Jugut	2224	5
	Shipol	1	1
Obiliq		1654	3
	Obiliq	559	1
	Mazgit	215	1
	Miloshevë	151	1
Pejë		4990	15
	Pejë	2398	14
	Vitomicë	320	1
Podujevë		4882	6
	Podujevë	1383	2
	Sfeçël	92	1
	Lluzhan	48	1
	Orllan	39	1
	Kërpimeh	26	1
Prishtinë		15846	101
	Prishtinë	9491	90
	Matiçan	3262	2
	Çagllavicë	541	5
	Hajvali	539	1
	Sofali	116	2
	Besi	43	1
Prizren		9777	12
	Prizren	4669	12
Rahovec		2850	4
	Rahovec	1034	1
	Xërxë	189	1
	Krushë e Madhe	184	1
	Ratkoc	155	1
Shtime		1793	5
	Shtime	576	3
	Godanc i Epërm	92	1
	Muzeqinë	59	1
Skenderaj		2628	2
	Skënderaj	612	2

Komuna	Vendbanimi	Fëmijë të moshës 0-4 vjeç	Numri i institucioneve parashkollore
Suharekë		2886	12
	Suharekë	652	5
	Sopië	165	1
	Studençan	160	1
	Mushtisht	150	1
	Gjinoc	111	1
	Samadrexhë	111	1
	Duhël	56	1
	Bukosh	51	1
Viti		2403	3
	Viti	407	1
	Drobesh	127	1
	Çifllak	5	1
Vushtrri		4263	8
	Vushtrri	1993	8

Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Drejtoritë e Arsimit të komunave dhe llogaritjet e GAP-it

Po ashtu, shpërndarja është e pabarabartë në Mitrovicën e Jugut, ku vendbanimet si Zijaqa, Suhadolli i Poshtëm dhe Tërstena, me mbi 200 fëmijë, nuk kanë asnjë institucion. Ngjashëm, në Ferizaj vetëm një vendbanim jashtë qendrës ka institucion parashkollor, ndërsa vendbanimet e tjera të mëdha si Pleshina, Talinoci, Nekodima dhe Komogllava, nuk kanë asnjë institucion parashkollor. Për më tepër, edhe Drenasi paraqet një shpërndarje të pabarabartë ku vetëm tre nga 35 vendbanime kanë institucione parashkollore, përfshirë një vendbanim me dy institucione parashkollore për vetëm 137 fëmijë, ndërsa vendbanimet e tjera si Tërsteniku, Llapushniku dhe Nekoci, me mbi 200 fëmijë, janë pa asnjë institucion parashkollor. Në Podujevë, rreth tre institucione parashkollore ndodhen në vendbanime me mesatarisht 50 fëmijë, si Lluzhan, Orllan dhe Kërpimëh, ndërsa gjashtë vendbanime me mbi 150 fëmijë janë pa asnjë institucion parashkollor. Në disa komuna të tjera, shpërndarja e institucioneve parashkollore është e përqendruar vetëm në vendbanimin kryesor (qytet), duke lënë shumë fëmijë të tjerë në komunë pa institucione parashkollore pranë tyre. Komunitat me numrin më të madh të fëmijëve ku të gjitha institucionet parashkollore janë të përqendruara vetëm në qytet (një vendbanim) janë: Prizreni, Vushtrria, Malisheva, Skenderaj, Klina, Kaçaniku, Deçani, Dragashi dhe Kamenica.

Në anën tjetër, në disa komuna shpërndarja e institucioneve parashkollore nëpër vendbanime është më e balancuar. Komuna e Gjilanit është njëra prej tyre, pasi tri vendbanimet me më së shumti fëmijë, si Livoçi i Ulët, Livoçi i Epërm dhe Zhegra, kanë gjithashtu institucione parashkollore, duke pasqyruar një përshtatje më të mirë të ofertës me kërkesën. Ngjashëm, në Suharekë situata është më e mirë, ku nga shtatë vendbanimet që kanë institucione parashkollore, pesë prej tyre, si Sopia, Studençani, Mushtishti, Gjinoci dhe Samadrexha, kanë një numër më të lartë fëmijësh (mbi 100 fëmijë). Obiliqi gjithashtu paraqet një shpërndarje më të mirë, pasi tri vendbanimet me më së shumti fëmijë kanë po ashtu institucione parashkollore. Prishtina shfaq një situatë deri diku të balancuar, ku nga 11 institucione parashkollore që ndodhen në vendbanime më të vogla, tetë prej tyre gjenden në zona me numër më të lartë fëmijësh (më shumë se 500 fëmijë). Ndërkaq, ka disa vendbanime me mbi 100 fëmijë, si Bardhoshi, Kolovica, Barileva, Bërnica e Epërme dhe Prugoci, të cilat nuk kanë fare qasje në institucione parashkollore.

Bazuar në rezultatet e mësipërme, në shumë komuna të Kosovës ka një shpërndarje të pabarabartë të institucioneve parashkollore mes zonave urbane dhe atyre rurale. Në shumë raste, vërehet një përqendrim i theksuar në zonat urbane, duke neglizhuar vendbanime rurale me numër të madh fëmijësh. Për më tepër, në disa raste, institucionet parashkollore janë ndërtuar pa një planifikim të duhur, në vendbanime ku numri i fëmijëve është i ulët dhe, si rrjedhojë, kërkesa është e vogël. Kjo shpërndarje përjashton shumë fëmijë në zonat rurale nga edukimi në fëmijërinë e hershme dhe vendos pengesa shtesë për prindërit, veçanërisht gratë, të cilat përballen me vështirësi në balancimin e punës me përgjegjësitë e papaguara të kujdesit.

Këto pabarazi gjeografike ndërlidhen gjithashtu me një koordinim të dobët ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe me kapacitetet e kufizuara të komunave për të planifikuar dhe zgjeruar infrastrukturën e kujdesit. Komunitat shpesh përballen me kufizime financiare, vështirësi në sigurimin e tokës së përshtatshme për objekte të reja dhe me një shkallë të lartë varësie nga financimet dhe iniciativat e nivelit qendror. Për më tepër, në rastet kur vendimet për investime nuk udhëheqen mjaftueshëm nga planifikimi i bazuar në demografi dhe nevoja reale, ekziston rreziku që lokacioni i institucioneve të reja të reflektojë më shumë prioritete afatshkurtra ose premtime politike lokale, sesa nevojat e zonave me kërkesë më të madhe. Kjo mund të përforcojë edhe më tej dallimet në mes vendbanimeve urbane dhe atyre rurale. Duke pasur parasysh largësinë e institucioneve parashkollore nga vendbanimet, shumë fëmijë dhe familje përballen me sfida të transportit, pasi shumë fshatra nuk kanë fare qasje në transportin publik. Për më tepër, oraret shpesh janë të kufizuara dhe nuk u përshtaten atyre, ndërsa kostoja e transportit krijon një barrë shtesë financiare për familjen.²⁷ Këto pengesa jo vetëm kufizojnë qasjen e fëmijëve në shërbimeve parashkollore, por limitojnë edhe aftësinë e grave të hyjnë ose të mbeten në punë, veçanërisht kur mungojnë zgjidhjet alternative të kujdesit.

4. Ndikimi i institucioneve të kujdesit në përfshirjen e grave në tregun e punës

4.1. Pjesëmarrja e grave në tregun e punës në Kosovë

Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun e punës mbetet një sfidë si në Kosovë ashtu edhe në vende të tjera në të gjithë botën. Sipas të dhënave nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, pjesëmarrja e grave në nivel global është 49%, e që është për 25 pikë përqindjeje më e ulët se ajo e burrave.²⁸ Në Kosovë, pjesëmarrja e grave në tregun e punës është shumë më e ulët se mesatarja globale, rreth 26% në vitin 2024, dhe krahasuar me pjesëmarrjen e burrave, është 35 pikë përqindjeje më e ulët. Ndërsa, joaktiviteti i grave në Kosovë në vitin 2024 ishte rreth 74%.²⁹ Krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të Bashkimit Evropian, ku shkalla e punësimit të grave është përkatësisht 46% dhe 53%, Kosova renditet si vendi me shkallën më të ulët në Evropë.³⁰

Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në shkallën e ulët të punësimit të grave në Kosovë janë arsyet personale ose familjare, si dhe kujdesi për fëmijët ose të rriturit me aftësi të kufizuara, që përbëjnë rreth 32% të këtyre faktorëve. Një tjetër faktor i përmendur nga gratë është pamundësia për të gjetur punë me orar të plotë (31%), si dhe preferenca për punë me orar të pjesshëm (gjysmë

²⁷ Democracy for Development Institute. [Public Transport and Kindergartens as Prerequisites for the Country's Rapid Development](#). 2025. Qasur më 23 nëntor, 2025.

²⁸ Banka Botërore. [Childcare regulation and women's participation in the labor force](#). 2023. Qasur më 23 nëntor, 2025.

²⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). [Anketa e Fuqisë Punëtore: Popullsia ekonomikisht jo aktive dhe shkalla e popullsisë ekonomikisht jo aktive si pjesë e popullsisë në moshë pune sipas gjinisë, grupmosha 15 – 64, 2012 – 2024](#). Qasur më 23 nëntor, 2025.

³⁰ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). [The impact of care responsibilities on women's labour force participation](#). 2024. Qasur më 23 nëntor, 2025.

orari).³¹ Këta faktorë të mospërfshirjes së grave në tregun e punës reflektojnë normat shoqërore dhe tradicionale që përcaktojnë ndarjen gjinore të roleve të kujdesit. Kjo ndarje tradicionale ngarkon kryesisht gratë me përgjegjësitë për kujdesin e fëmijëve dhe të moshuarve, si dhe me punët e shtëpisë.³²

Si rrjedhojë, këto rrethana shtojnë varësinë ekonomike të grave ndaj burrave, ulin pjesëmarrjen e tyre në fuqinë punëtore dhe ngadalësojnë zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik të vendit. Sa i përket kornizës ligjore, Kosova ka miratuar disa ligje³³ dhe dokumente strategjike³⁴ që kanë qëllim mbrojtjen, promovimin dhe trajtimin e barabartë të të drejtave të grave. Mbi këtë bazë, vendi vlerësohet me 85 pikë nga 100 të mundshme në indeksin e Bankës Botërore "Gratë, Biznesi dhe Ligji". Sidoqoftë, ky vlerësim evidenton një hendek të madh në zbatueshmëri, ku diferenca mes kornizës ligjore dhe zbatimit në terren mbetet tejet e lartë (43.8 pikë).³⁵ Kjo mbështetet edhe nga opinionet e ekspertëve mbi fuqizimin ligjor të grave: rreth 50% e tyre vlerësojnë se vetëm një pjesë e grave gëzojnë qasje në shërbime cilësore dhe të përballueshme për kujdesin e fëmijëve, ndërsa 17% pohojnë se ky shërbim është pothuajse krejtësisht i paqasshëm për to.

Sipas llogaritjeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), nëse shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës në Kosovë do të arrinte mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor (45%), numri i grave të punësuar do të rritej me afërsisht 180 mijë. Për rrjedhojë, përmes këtij zgjerimi të punësimit, FMN-ja parashikon një rritje potenciale prej rreth 23% të Bruto Produktit Vendor (ku 19% vjen nga mbyllja e hendekut të punësimit, 1.1% nga eliminimi i diferencës në orët e punës dhe 2.5% nga zvogëlimi i pabarazisë në paga)³⁶. Po ashtu, vlerësimet e bazuara në Indeksin e plotë GEGI³⁷ nga një studim tjetër, dëshmojnë se BPV-ja për kokë banori do të shënonte një rritje prej 21.1% në afatgjatë, nëse gratë do të ishin të angazhuara në tregun e punës me të njëjtin ritëm dhe në të njëjtat pozicione si burrat.³⁸

4.2. Ndërlidhja në mes të qasjes në institucione të kujdesit dhe punësimit të grave

Një nga faktorët kyç që ndikon në rritjen e punësimit të grave është adresimi i sfidës së kujdesit përmes ofrimit të shërbimeve dhe institucioneve të përballueshme financiarisht. Mbështetur në një studim³⁹ të realizuar në vendet me të ardhura të larta, ekziston një korrelacion pozitiv në mes investimeve në edukimin e hershëm dhe përmirësimit të treguesve të tregut të punës për gratë. Po ashtu, një tjetër hulumtim⁴⁰ që analizoi vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme konstatoi se zgjerimi i qasjes në institucionet parashkollore ka gjeneruar ndikim pozitiv në punësimin e grave. Për të stimuluar këtë trend dhe për të rritur pjesëmarrjen e

31 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Anketa e Fuqisë Punëtore: Arsytet e të punuarit orar të pjesshëm sipas gjinisë në përqindje (%), grupmosha 15–64, 2012–2024. Qasur më 23 nëntor, 2025.

32 Instituti Riinvest. [Unlocking potential: the economic cost of women's untapped potential](#). 2025. Qasur më 25 nëntor, 2025.

33 Gazeta Zyrtare e Kosovës. [Ligji Nr. 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore; Ligji Nr. 08/L-185 mbi Parandalimin e dhe Mbrojtjen nga Dhuna Familjare, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna e Bazuar në Gjini; Ligji Nr. 2004/32 mbi Familjen e Kosovës](#). Qasur më 23 nëntor, 2025.

34 Agjencia për Barazinë Gjinore. [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#). 2025. Qasur më 23 nëntor, 2025.

35 Banka Botërore. Women, Business and the Law 2024. [Kosovo](#). Qasur më 23 nëntor, 2025.

36 Fondi Monetar Ndërkombëtar. [Labor Market and Gender. Republic of Kosovo](#). 2025. Qasur më 23 nëntor, 2025.

37 Indeksi GEGI mat diferencën midis raportit të punësimit të burrave ndaj popullsisë së burrave në moshë pune (Lm) dhe raportit të punësimit të grave ndaj popullsisë së grave në moshë pune (Lf), si një pjesë e raportit të punësimit të përgjithshëm ndaj popullsisë në moshë pune (Lm+Lf).

38 Instituti Riinvest. [Unlocking potential: the economic cost of women's untapped potential](#). 2025. Qasur më 25 nëntor, 2025.

39 Olivetti, C. and Petrongolo, B. [The Economic Consequences of Family Policies: Lessons from a Century of Legislation in High-Income Countries](#). 2017. Qasur më 23 nëntor, 2025.

40 Halim, D. Perova, E. and Reynolds, S. [Childcare and Mothers' Labor Market Outcomes in Lower- and Middle-Income Countries](#). 2023. Qasur më 23 nëntor, 2025.

grave në fuqinë punëtore, një raport i Bankës Botërore sygjeron se shtetet duhet të reformojnë legjislacionin për shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve, duke rregulluar qasjen dhe disponueshmërinë e tyre. Raporti evidenton një disbalancë të theksuar mes kërkesës dhe ofertës në këtë treg; ndonëse kërkesa për këto shërbime mbetet e lartë, rreth 40% e fëmijëve të moshës parashkollore nuk arrijnë t'i qasen atyre. Si rrjedhojë, gjetjet e këtij studimi rikonfirmojnë se reformat ligjore janë të domosdoshme për të lehtësuar integrimin e fëmijëve dhe grave në sistemin parashkollor.⁴¹ Një raport nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) tregon se ka një lidhje mes pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe pjesëmarrjes së fëmijëve nën moshën 3 vjeç në institucionet parashkollore. Sipas këtij raporti, vendet me pjesëmarrjen më të lartë të grave në tregun e punës, si Danimarka, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Sllovenia dhe Zvicra, kanë gjithashtu një përqindje të lartë të fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor. Për më tepër, gjetjet e këtij raporti tregojnë se ka një korrelacion mes orëve të fëmijëve në institucionet parashkollore dhe orëve të punës së grave. Si rezultat, në vendet ku fëmijët kalojnë më pak orë në institucionet parashkollore, si Holanda dhe Zelanda e Re, më shumë se 40% e grave me fëmijë janë të punësuar me orar të pjesshëm.⁴²

Ndër barrierat kryesore që kufizojnë kërkesën në tregun e kujdesit ndaj fëmijëve veçohen: kostoja financiare, vendndodhja, oraret e mbylljes, cilësia e shërbimit, si dhe normat socio-kulturore. Kostot e larta janë pengesa serioze të shumë familjeve, veçanërisht atyre me të ardhura të ulëta. Po ashtu, distanca gjeografike dhe oraret e kufizuara të punës i privojnë prindërit nga regjistrimi i fëmijëve në këto institucione. Standardet e ofrimit të shërbimit dhe shkalla e besueshmërisë mbeten faktorë të tjerë përcaktues. Për më tepër, normat shoqërore shpesh i zmbresin prindërit nga përdorimi i këtyre shërbimeve, çka reflektohet direkt në mospërfshirjen e grave dhe nënave në tregun e punës.⁴³ Në këtë kuadër, disa shtete të Evropës dhe Azisë Qendrore, si Turqia dhe Ukraina, aplikojnë masa ku punëdhënësit obligohen ligjërisht të ofrojnë ose të subvencionojnë shërbimet e kujdesit nën kushte të caktuara.

Në Turqi, korporatat që punësojnë të paktën 150 gra janë të detyruara të ofrojnë shërbime të kujdesit ose kuponë (voucher) financiarë që mundësojnë përdorimin e shërbimeve në institucione të licensuara. Ngjashëm, legjislacioni në Ukrainë obligon punëdhënësit me numër të madh të punonjëseve gra të organizojnë shërbime të kësaj natyre. Një tjetër element përcaktues për qasjen në këto shërbime është mosha minimale e pranimi të fëmijëve. Në shtetet si Moldavia, Taxhikistani dhe Uzbekistani, këto shërbime ofrohen që nga lindja. Përkundrazi, në vende si Turqia, institucionet publike i pranojnë fëmijët vetëm pasi arrijnë moshën 3-vjeçare. Kufizimet e moshës minimale të pranimi penalizojnë kryesisht gratë, duke ua vështirësuar riintegrimin në tregun e punës pas periudhës së lindjes. Nga ana tjetër, lejet e zgjatura të lindjes të paguara mirë, ndonëse përbëjnë një mbështetje të rëndësishme financiare për familjet, mund të shërbejnë si faktor dekurajues për një rikthim të shpejtë të grave në jetën profesionale, duke rritur rrjedhimisht pabarazinë gjinore në mjedisin e punës.⁴⁴

Një tjetër faktor përcaktues që ndikon në kërkesën për shërbime parashkollore mbetet përballueshmëria financiare. Shumë shtete aplikojnë politika mbështetëse financiare ose jofinanciare për prindërit, për të reduktuar kostot dhe për të lehtësuar qasjen, veçanërisht për familjet në nevojë. Një politikë mbështetëse është tatimi preferencial, përmes të cilit prindërit mund të përfitojnë lehtësime

41 Banka Botërore. [Filling the Gaps: Childcare Laws for Women's Economic Empowerment](#). Qasur më 23 nëntor, 2025.

42 Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). [How does access to early childhood services affect the participation of women in the labour market?](#) 2018. Qasur më 23 nëntor, 2025.

43 Banka Botërore. Women, Business and the Law 2022. [Toward available, affordable, and quality childcare in Europe and Central Asia](#). 2022. Qasur më 23 nëntor, 2025.

44 Po aty

tatimore përmes një zbritjeje të tatimit në të ardhurat personale.⁴⁵ Ofrimi i shërbimeve të qasshme dhe ekonomikisht të përballueshme, përtej stimulimit të pjesëmarrjes së grave në forcën punëtore, rrit njëkohësisht edhe produktivitetin e tyre në mjedisin e punës duke u siguruar kohën e nevojshme për t'u fokusuar në karrierë. Për pasojë, integrimi i tyre në tregun e punës ndikon drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies dhe në forcimin e stabilitetit të tyre financiar.⁴⁶

Në Kosovë, ekzistojnë disa faktorë që krijojnë barriera për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës: normat kulturore dhe sociale, përgjegjësitë familjare, qasja e kufizuar në shërbimet e kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit, transporti dhe kostoja e pushimit të lehonisë për punëdhënësit. Përveç qasjes së kufizuar në institucionet parashkollore dhe të kujdesit për të moshuarit të diskutuar më lart, një faktor i rëndësishëm që është shumë i theksuar në Kosovë, dhe që e pozicionon kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve si përgjegjësi të grave, janë normat kulturore. Kjo krijon pabarazi gjinore në familje, pasi gratë kalojnë shumë kohë të angazhuara në "punë të papaguar" pa pasur mundësi të bëhen pjesë e tregut të punës. Sipas llogaritjeve të një raporti⁴⁷, gratë në Kosovë shpenzojnë rreth 6 orë në ditë në punë të papaguar, ndërsa burrat shpenzojnë rreth 44% më pak, e që është gjithsej rreth 3.5 orë në ditë. Ndërkohë, vlera e përgjithshme e punës së papaguar vlerësohet të jetë rreth 2.8 miliardë euro, ose 33% e Bruto Produktit Vendor të Kosovës.⁴⁸

Përtej faktorëve të lartpërmendur, një tjetër sfidë që cenon punësimin e grave në vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet mungesa e vendeve formale të punës me orare fleksibile. Banka Botërore (BB) evidenton se ofertat e punës që ofrojnë fleksibilitet apo punësim me kohë të pjesshme janë mjaft të rralla në treg, gjë që thellon hendekun gjinor të pagave dhe zbeh interesin e grave për t'u integruar profesionalisht. Si zgjidhje alternative, BB sygjeron zgjerimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit, proces ky që do të gjeneronte paralelisht edhe vende pune cilësore në sektorin e kujdesit. Ndërkohë, shtetet duhet të garantojnë gjithashtu përballueshmërinë financiare të këtyre institucioneve.⁴⁹

Një tjetër faktor i rëndësishëm që krijon barriera për punësimin e grave, veçanërisht në zonat rurale, është qasja dhe kostoja e transportit. Në shumë fshatra, familjet nuk kanë qasje në transport, ose transporti është i shtrenjtë, duke krijuar pengesa për shumë gra që të hyjnë në tregun e punës ose qoftë edhe në aftësim profesional. Sipas një analize⁵⁰ në disa fshatra në Kosovë, rreth 12% e të anketuarve përmendën koston e transportit si arsye për të mos kërkuar punë. Për më tepër, një tjetër faktor që kufizon mundësitë e punësimit të grave është ndërprerja e punës pas lindjes së fëmijës dhe kostoja e pushimit të lehonisë për punëdhënësit. Në këtë drejtim, legjislacioni për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror duhet të rishikohet, me qëllim që të krijohen mundësi të barabarta për të dy prindërit, dhe të mos mbetet barra vetëm mbi gruan.⁵¹

45 Banka Botërore. Women, Business and the Law 2022. [Toward available, affordable, and quality childcare in Europe and Central Asia](#). 2022. Qasur më 23 nëntor, 2025.

46 Banka Botërore [The Effects of Childcare on Women and Children. Evidence from a Randomized Evaluation in Burkina Faso](#). 2022. Qasur më 23 nëntor, 2025.

47 Instituti Musine Kokalari. [Who Cares? Unpaid Care Work in Kosovo](#). (2022). Qasur më 23 nëntor, 2025.

48 Po aty

49 Banka Botërore. [Towards Better Jobs](#). Western Balkans Regular Economic Report. 2025. Qasur më 23 nëntor, 2025.

50 Democracy for Development Institute. [Public Transport and Kindergartens as Prerequisites for the Country's Rapid Development](#). (2025). Qasur më 23 nëntor, 2025.

51 Unicef. [Analysis of the situation of women and children in Kosovo](#). 2019. Qasur më 23 nëntor, 2025.

4.2.1 Joaktiviteti dhe papunësia e grave në Kosovë sipas komunave dhe korrelacioni me disponueshmërinë e institucioneve parashkollore

Për analizë të mëtejshme, ky raport analizon marrëdhënien mes disponueshmërisë së institucioneve parashkollore në komuna dhe treguesve të tregut të punës për gratë duke llogaritur korrelacionin në mes të disponueshmërisë së IP-ve dhe joaktivitetit dhe papunësisë në nivel komunal. Analiza synon të shqyrtojë nëse komunat me disponueshmëri më të lartë të IP-ve kanë shkallë më të ulëta të joaktivitetit dhe papunësisë së grave. Të dhënat për papunësinë dhe joaktivitetin e grave u morën nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2024, dhe jo nga Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP). Përdorimi i të dhënave të regjistrimit të popullsisë mundëson analizën e këtyre treguesve në nivel komunal.

Marrëdhënia mes disponueshmërisë së shërbimeve parashkollore dhe rezultateve të tregut të punës për gratë u vlerësua duke përdorur koeficientin⁵² e korrelacionit të Pearson-it, të llogaritur në të 27 komunat. Koeficienti mat drejtimin dhe fuqinë e marrëdhënies lineare mes numrit të IP-ve për 1,000 fëmijë dhe treguesit përkatës të tregut të punës. Rezultatet tregojnë që ka një korrelacion negativ mesatar ($r = -0.48$) mes disponueshmërisë së shërbimeve parashkollore dhe joaktivitetit të grave. Kjo tregon se komunat me më shumë IP në raport me numrin e fëmijëve priren, mesatarisht, të kenë shkallë më të ulëta të joaktivitetit të grave. Marrëdhënia është më e fortë për papunësinë, me një koeficient korrelacioni prej $r = -0.63$, gjë që sugjeron se komunat me disponueshmëri më të madhe të shërbimeve parashkollore gjithashtu priren të kenë shkallë më të ulëta të papunësisë së grave.

Tabela 3. Përqindja e punësimit dhe joaktivitetit për gratë e moshës 15–64 vjeç, sipas komunave

Komuna	Shkalla e papunësisë së grave	Shkalla e joaktivitetit për gratë	IP / 1,000 fëmijë
Deçan	25.9%	76.1%	1.0
Dragash	52.3%	85.2%	0.5
Drenas	26.5%	68.9%	1.4
Ferizaj	15.1%	65.6%	1.2
Fushë Kosovë	10.6%	53.2%	3.2
Gjakovë	17.3%	63.8%	3.7
Gjilan	21.5%	58.5%	2.2
Hani i Elezit	8.3%	86.3%	1.3
Istog	17.0%	69.4%	2.2
Junik	10.9%	81.7%	4.7
Kaçanik	29.1%	71.4%	0.4
Kamenicë	25.5%	69.4%	0.7
Klinë	26.6%	74.5%	0.4
Lipjan	16.2%	68.7%	2.0

⁵² Koeficienti i korrelacionit të Pearson-it (shpesh i shkruar si r) është një numër nga -1 në 1 që mat fuqinë dhe drejtimin e një marrëdhënieje lineare midis dy grupeve të numrave. Ai llogaritet duke pjesëtuar (kovariancën) e variablave me devijimet e tyre standarde. Një korrelacion pozitiv është kur $r > 0$ dhe një korrelacion negativ është kur $r < 0$.

Malishevë	33.1%	79.8%	0.5
Mitrovicë	25.9%	62.3%	1.2
Obiliq	11.6%	67.6%	1.5
Pejë	14.1%	64.3%	2.5
Podujevë	22.5%	73.2%	1.0
Prishtinë	7.2%	46.1%	5.2
Prizren	16.2%	72.2%	1.0
Rahovec	21.7%	81.6%	1.2
Shtime	21.5%	72.2%	2.3
Skenderaj	32.3%	74.9%	0.6
Suharekë	19.2%	73.6%	3.5
Viti	26.2%	71.7%	1.0
Vushtrri	19.5%	69.3%	1.5

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024) dhe llogaritje të GAP

Prishtina dallon duke kombinuar disponueshmërinë më të lartë të institucioneve parashkollore (5.2 IP për 1,000 fëmijë) me shkallën më të ulët të joaktivitetit të grave (46.1%) dhe shkallën më të ulët të papunësisë (7.2%). Fushë Kosova gjithashtu performon më mirë, me 3.2 IP për 1,000 fëmijë, një shkallë të joaktivitetit të grave prej 53.2% dhe papunësi prej 10.6%. Gjakova dhe Peja ngjashëm kombinojnë disponueshmëri relativisht të lartë të IP-ve me shkallë krahasimisht të ulëta të joaktivitetit dhe papunësisë. Në anën tjetër, Dragashi është ndër performuesit më të dobët, me vetëm 0.5 IP për 1,000 fëmijë, dhe një shkallë shumë të lartë të joaktivitetit të grave prej 85.2% dhe shkallë të papunësisë prej 52.3%. Malisheva, Klina, Kaçaniku dhe Skenderaj gjithashtu kombinojnë disponueshmëri relativisht të ulët të IP-ve me shkallë të larta të joaktivitetit dhe/apo papunësisë. Megjithatë, ka disa përjashtime, të cilat shfaqen si vlera të veçuara (outliers). Juniku, për shembull, ka treguesin e dytë më të lartë të IP-ve (4.7) por një shkallë të lartë të joaktivitetit të grave prej 81.7%, ndërsa Hani i Elezit ka disponueshmëri relativisht të ulët të IP-ve (1.3) por një nga shkallët më të ulëta të papunësisë (8.3%). Këto raste demonstrojnë se disponueshmëria e IP-ve nuk është faktori i vetëm që përcakton pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

Prandaj, gjetjet duhet të interpretohen si një ndërlidhje dhe jo një lidhjeje shkak-pasojë. Korrelacioni i Pearson-it shfaq një marrëdhënie lineare mes dy variablave në nivel komunal, por nuk kontrollon për faktorë të tjerë që mund të ndikojnë si në ofrimin e arsimit parashkollor, ashtu edhe në rezultatet e tregut të punës, duke përfshirë kushtet ekonomike lokale, mundësitë e punësimit, të ardhurat familjare, urbanizimin, arsimin ose qasjen në forma të tjera të kujdesit për fëmijët. Përveç kësaj, treguesi i IP-ve mat disponueshmërinë relative të institucioneve, por nuk pasqyron nëse vendet janë të përballueshme financiarisht, gjeografikisht të qasshme, të disponueshme për të gjithë fëmijët ose nëse shfrytëzohen aktualisht nga familjet. Në përgjithësi, analiza sugjeron se komunat me disponueshmëri më të madhe të shërbimeve parashkollore shfaqin rezultate më të favorshme për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, veçanërisht sa i përket papunësisë. Edhe pse marrëdhënia nuk mund të interpretohet si shkak-pasojë, rezultatet ofrojnë dëshmi mbështetëse për të marrë parasysh zgjerimin dhe shpërndarjen e barabartë të shërbimeve parashkollore si pjesë e politikave më të gjera që synojnë reduktimin e barrierave ndaj pjesëmarrjes ekonomike të grave.

5. Përfundime dhe rekomandime

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se infrastruktura aktuale e institucioneve parashkollore dhe e qendrave për të moshuarit nuk përputhet me nevojat demografike të popullsisë, duke krijuar kështu edhe më shumë barriera për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Edukimi në fëmijërinë e hershme mbetet i nënzhvilluar, me vetëm 26% të fëmijëve të moshës 0–<6 vjeç të regjistruar në institucionet parashkollore, një nivel shumë më i ulët se mesatarja rajonale dhe larg objektivave të Bashkimit Evropian. Shpërndarja gjeografike e institucioneve parashkollore është e pabarabartë, me qasje të ulët në zonat rurale dhe me disa komuna që kanë vetëm një institucion për të gjithë territorin, me gjithë numrin e madh të fëmijëve. Kjo tregon se kapacitetet aktuale në shumë komuna janë jo vetëm të pamjaftueshme, por edhe të shpërndara në mënyrë joefikase. Sa i përket sektorit të kujdesit ndaj të moshuarve, në nivel vendi operojnë vetëm 15 institucione publike dhe me bazë në komunitet (duke përfshirë komunat me shumicë serbe), të cilat mbeten të përqendruara kryesisht në qendrat e mëdha urbane. Për pasojë, mjaft komuna me përqendrim të lartë të popullsisë mbi 65 vjeç kanë mungesë të plotë të shërbimeve të kësaj natyre. Në mungesë të strukturave formale mbështetëse, familjet detyrohen ta absorbojnë këtë ngarkesë përmes punës së papaguar të kujdesit, një barrë kjo që rëndon në mënyrë joproporcionale mbi kohën dhe mundësitë profesionale të grave. Prandaj, ofrimi i shërbimeve rezidenciale dhe ditore për të moshuarit mbetet jetik për të zbutur ndarjen e pabarabartë të punëve të shtëpisë dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e grave si pjesë aktive e fuqisë punëtore.

Gjetjet po ashtu rikonfirmojnë se investimi në infrastrukturën e kujdesit përbën një investim direkt në kapitalin njerëzor dhe potencialin ekonomik të Kosovës. Zgjerimi i shërbimeve të qasshme dhe gjeografikisht të balancuara për fëmijët dhe të moshuarit do të lironte kohën e grave nga punët e papaguara, duke stimuluar punësimin, qëndrueshmërinë dhe avancimin e tyre në karrierë, si dhe duke u mundësuar familjeve maksimizimin e kapaciteteve të tyre produktive. Paralelisht, zgjerimi i këtij sektori gjeneron vende të reja pune dhe ndikon në zhvillimin e ekonomisë së kujdesit. Përfitimet e kësaj politike tejkalojnë ekonomitë familjare dhe reflektohen në makroekonomi përmes rritjes së shkallës së aktivitetit, zgjerimit të punësimit, rritjes së të ardhurave të disponueshme dhe një fuqie punëtore më dinamike e produktive.

Për rrjedhojë, të gjetjet e raportit theksojnë nevojën e një kthese strategjike: kujdesi ndaj fëmijëve dhe të moshuarve nuk duhet të trajtohet më thjesht si çështje e ndihmës sociale apo e politikave të mirëqenies, por duhet të njhet si një investim parësor struktural për pjesëmarrjen në tregun e punës, barazinë gjinore dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Mbështetur në këto gjetje, ky raport ofron këto rekomandime:

Për nivelin lokal (komunat):

- Zgjerimi i kapaciteteve të arsimit parashkollor dhe parafillor përmes investimeve në ndërtimin e institucioneve të reja parashkollore ose përshtatjen e shkollave ekzistuese për institucione parashkollore në komunat me raport të ulët të institucioneve parashkollore për 1,000 fëmijë, veçanërisht në ato me më pak se një institucion parashkollor për 1,000 fëmijë. Investimet duhet të bazohen në nevojat dhe trendet demografike sipas vendbanimeve, duke u dhënë prioritet zonave rurale dhe vendbanimeve me popullsi të madhe fëmijësh, ku infrastruktura mungon plotësisht. Më konkretisht, bazuar në gjetjet e këtij raporti, më poshtë janë të listuara nevojat për investime në kapacitete të reja sipas komunave, të listuara sipas nivelit të nevojës dhe prioritetit:
 - Në komunat si Vitia, Podujeva, Deçani, Kamenica, Skenderaj, Dragashi, Malisheva, Kaçaniku dhe Klina, ku ka një ose më pak se një institucion

parashkollor për 1,000 fëmijë, hapja e institucioneve parashkollore, ose përshtatja e shkollave për institucione parashkollore, duhet të jetë prioritare.


- Në Skenderaj, ku dy institucionet parashkollore funksionale ndodhen në qendër, rreth së cilës ndodhen edhe fshatrat me numrin më të madh të fëmijëve, një mundësi do të ishte hapja/përshtatja e institucioneve parashkollore në fshatrat Rezallë, Klinë e Epërme dhe Burojë, duke u mundësuar edhe fshatrave përreth që të përfitojnë.
- Në Prizren, ku të gjitha institucionet parashkollore ndodhen në qytet, dhe i cili ka numrin më të madh të fëmijëve të moshës 0-4 vjeç pas Prishtinës, hapja e të paktën dy deri në tre institucioneve parashkollore duhet të jetë prioritare. Për të siguruar një shpërndarje më të mirë gjeografike, IP-të mund të jenë në fshatrat Lubizhdë e Hasit, Zhur, Korishë dhe/ose Lubinjë e Poshtme (fshatra me më shumë se 100 fëmijë).
- Në Mitrovicën e Jugut, hapja/përshtatja e institucioneve parashkollore në fshatrat Zijaqë, Suhadoll i Poshtëm dhe Tërstenë duhet të jetë prioritare, duke pasur parasysh se këto të gjitha kanë më shumë se 200 fëmijë.
- Në Ferizaj, ku vetëm një nga fshatrat (Greme) ka një institucion parashkollor përveç qendrës, hapja e institucioneve parashkollore në Koshare dhe Sojevë ose Bibaj mund të jetë një opsion, dhe në këtë mënyrë fshatrat përreth me më shumë se 100 fëmijë si: Slivova, Nerodimja e Poshtme dhe e Epërme, Komogllava dhe Fshati i Vjetër mund të përfshihen.
- Në Drenas, institucionet parashkollore mund të ndërtohen/përshtaten në fshatrat Tërstenik dhe Nekoc, të cilat kanë më shumë se 200 fëmijë, dhe këto mund të përfshijnë gjithashtu fshatrat përreth si Kishnarekë, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulët.
- Në Vushtrri, ku të gjitha institucionet parashkollore ndodhen në qendër të qytetit, dy fshatra si opsione për ndërtimin/përshtatjen e institucioneve parashkollore janë Stanoci i Poshtëm dhe Pantina.
- Në Gjakovë, hapja e institucioneve parashkollore në fshatrat Damjan dhe Brekoc, si fshatra të mëdha pa asnjë IP, duhet të jetë prioritare. Hapja e IP-ve në këto dy fshatra mund t'u shërbejë gjithashtu fshatrave përreth, përmes ofrimit të transportit.
- Të shqyrtohet mundësia e përdorimit të ndërtesave ekzistuese të shkollave dhe përshtatja e tyre për institucione parashkollore, veçanërisht në ato vendbanime ku ka shkolla me një numër shumë të vogël nxënësish.
- Zgjerimi i shërbimeve për të moshuarit përmes krijimit të qendrave të reja të kujdesit ditor si një mundësi socializimi për ta dhe mbështetje në shtëpi për të ndihmuar me punët e përditshme. Komunitet me numër të madh të të moshuarve dhe pa asnjë institucion publik (si Peja, Gjakova, Mitrovica e Jugut, Podujeva, Vushtrria) duhet të jenë prioritare për hapjen e qendrave të kujdesit ditor.
- Rishikimi i kriterëve për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore publike duke krijuar mundësi të barabarta vlerësimi për fëmijët që i kanë të dy prindërit në marrëdhënie pune dhe ata që kanë vetëm një prind në marrëdhënie pune. Kriteret aktuale të pranimit i vlerësojnë fëmijët që kanë vetëm një prind në punë me më pak pikë, duke reduktuar shanset e tyre për regjistrim, dhe si rrjedhojë duke ndikuar në punësimin e prindit të tyre, i cili në shumicën e rasteve është nëna. Rishikimi mund të shqyrtojë mundësinë e përcaktimit të kriterëve që u japin përparësi fëmijëve, nënat e të cilëve hyjnë për herë të parë në tregun e punës, marrë parasysh qasjen në arsimin parashkollor si një faktor të rëndësishëm që lehtëson kycjen e grave në tregun e punës. Një qasje e tillë mund të plotësonte kriteret ekzistuese të bazuara në të ardhurat familjare dhe cënueshmërinë sociale, duke siguruar që regjistrimi në institucionet parashkollore gjithashtu mbështet gratë në kalimin nga puna e papaguar e kujdesit në punësim të paguar. Masa të tjera mund të përfshijnë ndarjen e një pjese të përcaktuar të vendeve të lira për fëmijët nga vendbanimet rurale të nënshërbyera ose zona të tjera me qasje të kufizuar në shërbimet parashkollore.

Për nivelin qendror:

Të krijohen politika familjare të përgjegjshme ndaj perspektivës gjinore për punësimin e grave përmes subvencionimit të shërbimeve parashkollore për fëmijët e grave që punësohen për herë të parë. Gjithashtu, të krijohen politika mbështetëse për zgjerimin dhe subvencionimin e shërbimeve të transportit nëpër fshatra, duke pasur parasysh se ato paraqiten si një nga sfidat në qasjen e grave në tregun e punës.

Aneks

Figura 1. Numri i qendrave (shtëpitë rezidenciale dhe qendrat e kujdesit ditor) për të moshuarit sipas komunave





Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mesqeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

